



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 622 Prot.

Tiranë, më 22.02. 2024

VENDIM QARKULLUES

Nr. 14 dt. 22.02 2024

**“PËR  
SHTYRJEN E AFATIT PËR APLIKIM TË KANDIDATËVE TË KOMISIONIT  
INSTITUCIONAL ZGJEDHOR (KIZ), PËR ZGJEDHJET E AUTORITETEVE DHE  
ORGANEVE DREJTUESE NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 3, 36, 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 7, 18 dhe 20 të Statutit të UST-së, nenit 7 të Rregullores së UST-së, nenit 6 të Rregullores për Organizmin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit për aplikim të kandidatëve të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ).
2. Regjistrimi i kandidatëve të bëhet pranë Zyrës së Arkiv- Protokollit të UST-së nga data 23.02.2024- 29.02.2024.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, drejtuesit e njësive kryesore si dhe Sekretari i Senatit Akademik.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KAS





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 622/ Prot.

Tiranë, më 22.02.2024

**NJOFTIM**

**mbi vetëkandidimin për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ)  
në UST**

Në zbatim të nenit 36 dhe 38 të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 18 dhe 20 të Statutit të UST-së, nenit 7 të Rregullores së UST-së, nenit 6 të Rregullores për Organizmin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST dhe Vendimit të Senatit Akademik nr. 14, datë 22.2.2024 për shtyrjen e procesit të vetëkandidimit;

Ftoheni të vetëkandidoheni për të qenë anëtarë të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ) nëse plotësoni kriteret e përcaktuara në nenin 6 të Rregullores për Organizmin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST. Anëtari i KIZ nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të çdo niveli.

Regjistrimi do të kryhet në Zyrën e Arkiv-Protokollit të UST-së dhe do të vijojë nga data 23.02.2024- 29.02.2024.

Mbetemi në pritje të vetkandidimeve tuaja,

Faleminderit për mirëkuptimin!

**SEKRETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.Asoc. ROBERT ÇITOZI**